

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-31/18-06

Prishtinë, më 1 dhe 6 shtator 2006, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën në fillim e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 83 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Raportimi i Grupit Negociator për ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës

Kryetari i informoi deputetët për rendin e ditës dhe për qëllimin e kësaj seance. Ai e ftoi propozuesin e kësaj pike ta marrë fjalën.

Alush Gashi – kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se Grupi i Unitetit edhe pas vdekjes së kryetarit, dr. Ibrahim Rugova, vazhdoi rrugën për pavarësinë dhe për sovranitetin e vendit tonë. Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet përpjekjet vendore dhe ndërkombëtare për sigurim të plotë të të drejtave të njeriut në Kosovë pa dallim të përkatësisë etnike.

Rikonfirmojmë përcaktimin tonë se organizimi eventual i pushtetit lokal në vija etnike nuk është qëndrim i LDK-së. Kemi drojë për pasoja të një pranimi apo të një imponimi të tillë.

Jemi të interesuar të dëgjojmë nga Grupi i Unitetit lidhur me ecurinë e bisedimeve dhe të pikëpamjeve për zbatim të ashtuquajturit paket statusor në muajt në vijim.

Kryetari i ftoi përfaqësuesit e Grupit Negociator të raportonin para deputetëve të Kuvendit për ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës.

Fatmir Sejdiu - kryetar i Kosovës tha se Ekipi i Unitetit nëpërmjet delegacioneve- përfaqësuese të tij, ka paraqitur qëndrimet e veta në takimet e Vjenës për katër tema bosht, që janë trajtuar në shtatë takime të deritashme në Vjenë, si dhe në takimet e tjera me drejtuesin e këtyre bisedimeve me presidentin Ahtisari.

Ekipi i Unitetit, me gjithë strukturën e tij të brendshme të organizimit: Grupi Politik Strategjik dhe ekipet e specializuara për çështje kushtetuese-juridike, çështje ekonomike, çështjet e trashëgimisë kulturore, çështjet e të drejtave dhe të lirive të komuniteteve, në përbërjen e të cilave ka angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë ka artikulluar vullnetin politik të popullit të Kosovës për pavarësinë dhe sovranitetin e plotë të saj.

Të gjitha dokumentet e përgatitura janë marrë me konsensus të plotë nga anëtarët e Ekipit të Unitetit.

Delegacioni i Kosovës në bisedimet që ka pasur lidhur me decentralizimin është mbështetur gjithmonë në dokumentin e tij themelor “Parimet themelore të reformës së pushtetit lokal” të 14 shkurtit 2006, që si i tillë edhe do të jetë pjesë e marrëveshjes për statusin e ardhshëm të Kosovës. Bazuar në kriteret e parapara me këtë dokument, në vazhdim të procesit është nxjerrë edhe dokumenti i radhës për krijimin e komunave të reja në Kosovë. Në këtë dokument janë paraqitur kriteret për krijimin e komunave të reja.

Komunat e Kosovës do të gëzojnë kompetenca të gjera, duke filluar nga zhvillimi ekonomik dhe aspekte financiare, planifikimi urban, shërbimet publike, arsimi, shëndetësia dhe disa aspekte të përkujdesjes sociale. Njashtu do të ketë kompetenca të caktuara edhe në fushën e policisë siç është zgjedhja e komandantëve të stacioneve në bazë të propozimit të ministrit të **Rendit** dhe kjo duhet të reflektojë strukturën etnike brenda komunës. Reflektimi i kësaj strukture ka të bëjë edhe me përbërjen e gjyqtarëve.

Me këtë qasje kemi dëshiruar që të kontribuojmë në drejtim të integritimit sa më të madh të komunitetit pakicë serb në proceset vendimmarrëse, pra edhe në nivelin lokal të vendimmarrjes.

Qëndrimi i Delegacionit të Kosovës për çështjen e Mitrovicës për të cilën kemi theksuar se mund të organizohet një qytet me dy komuna, që do të udhëhiqeshin nga një bord i përbashkët administrativ i obligueshëm si organ ekzekutiv, në përbërje prej shtatë anëtarësh, nga tre përfaqësues nga secila komunë, pra të komuniteteve që u takojnë dhe një përfaqësues ndërkombëtar, që do të jetë udhëheqës i përkohshëm i këtij bordi administrativ.

Delegacioni i Kosovës ka zhvilluar edhe bisedime konkrete lidhur me çështjet ekonomike që kanë të bëjnë kryesisht me çështjen e borxheve të jashtme dhe pasurive të jashtme, me çështjet e pronës dhe më të drejtat e tjera, me interesat dhe detyrimet, me pensionet, depozitat bankare të ngrira në valuta të jashtme, me kërkesat e tjera të individëve për kompensim dhe humbjet kolektive.

Tema që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe religjioze është trajtuar në dy takime të gjertanishme.

Kaptinë të veçantë të bisedimeve paraqet çështja e trajtuar në takimin e Vjenës ,që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë.

Delegacioni i Kosovës punën e tij e ka mbështetur në dokumentin themelor, që e keni para vetes dhe si i tillë është miratuar nga Delegacioni i Kosovës. Nga përmbajtja e këtij dokumenti vlen të veçohet kujdesi i përkushtuar për integrimin e komuniteteve, pjesëmarrjen e tyre me përfaqësim të garantuar në Parlamentin e Kosovës, pjesëmarrjen e tyre në bazë të marrëveshjes politike me Qeverinë e Kosovës dhe parashikimi i mekanizmave përcjellës për mbrojtjen e interesave vitale të tyre.

Qëndrimet e Delegacionit janë në përputhje me Rezolutën e Kuvendit se “pavarësia e Kosovës është e panegociueshme”.

Delegacioni i Kosovës në Vjenë, me unitet të plotë dhe të palëkundshëm, ka shprehur përcaktimin e vet për një Kosovë evropiane në miqësi të përherëshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, në të njëjtën kohë kemi dhënë garancitë tona për të ardhmen e përbashkët në Kosovën e pavarur të të gjithë qytetarëve, pra të shumicës dhe të pakicës.

Kryeministri **Agim Çeku** – anëtar i Grupit Negociator tha se ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës ka qenë fuqizimi dhe mbështetja e procesit politik për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Qeveria është pjesëmarrës i barabartë në Grupin Negociator , që udhëhiqet nga presidenti Sejdiu.

Puna jonë në Grupin Negociator , në Grupin Politik Strategjik dhe me grupet e ekspertëve është vetëm njëra nga fushat mbështetëse të procesit, ndonëse proceset e tjera ,siç janë procesi i standardeve dhe implementimi i tyre kanë qenë dhe janë boshti kurrizor jo vetëm i definimit të statusit politik të Kosovës, por njëkohësisht edhe i marrëdhënieve të Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare.

Me anë të standardeve synojmë integrimin e pakicave në jetën politike, ekonomike, shoqërore dhe publike të Kosovës dhe avancimin e standardeve të gjithmbarshme në aspektin e ekonomisë, të sundimit të ligjit, të së drejtës pronësore, të stabilizimit të procesit demokratik. Të gjitha këto janë elemente esenciale drejtë ngritjes së kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës.

Roli mbështetës i Qeverisë për procesin negociator, si dhe roli i saj ekzekutiv në ofrimin e fakteve të pamohueshme politike i bëjnë të posaçëm rolin dhe rëndësinë që Qeveria ka gjatë këtij procesi.

Gjatë gjithë këtij procesi Qeveria i ka ndjekur me përpikëmeri parimet e përbashkëta të Delegacionit të Kosovës për negociata, si dhe të gjithë zgjidhjet duhet të garantojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës në tërë territorin e saj.

Njerëzit duhet t’i besojnë Ekipit të Unitetit, të udhëhequr nga presidenti Sejdiu, që do të jetë konsekuent drejt realizimit të synimit tonë të drejtë dhe fisnik për krijimin e një Kosove të lirë dhe të pavarur e demokratike.

Janë dy çështje kryesore që e kanë preokupuar opinionin publik dhe politik të Kosovës: decentralizimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore ,fetare në Kosovë.

Qëllimi ynë është ta bëjmë të mundur vetëqeverisjen lokale për pakicat, me fokus të veçantë për atë serbe dhe në të njëjtën kohë të ruhen funksionaliteti i shtetit dhe qeverisja demokratike në tërë Kosovën.

Gjatë bisedimeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare ne kemi dëshmuar se populli ynë nuk ka asnjë dilemë rreth mbrojtjes së tyre.

Udhëheqja e urtë, e vendosur dhe e guximshme e Ekipit të Unitetit, nën udhëheqjen e presidenti Sejdiu dhe pjesëmarrja aktive dhe konstruktive e të gjithë anëtarëve të Grupit është garanci për sukses në këtë proces.

Hashim Thaçi – anëtar i Grupit Negociator tha se Ekipi i Unitetit nuk është ekipi i plotë që u votua nga Kuvendi i Kosovës para një viti. Kjo po reflektohet në punën tonë. Ekipi i Unitetit fillimisht kishte mandat, fuqi, legjitimitet, përfaqësime dhe adresa të përgjegjësisë dhe llogaridhënëse. Ndryshimet kadrovike nuk e kanë përfshirë reflektimin e parashikuar në punën e Ekipit Negociator.

Gjatë procesit negociator, në momente të veçanta dhe delikate, janë vërejtur tendenca dhe prirje mediale të individualizimit të punëve ose të vrapit të keq në formën e grabitjes së suksesit të Ekipit të Unitetit. Megjithatë, Ekipi i Unitetit ka bërë punë në kontinuitet, ka prezantuar qëndrimet e përbashkëta që ka menduar së janë më të mirat.

Ekipi i Unitetit ka marrë vendime të urta. Uniteti ruhet dhe kultivohet duke investuar angazhim, përkushtim, seriozitet dhe vendosmëri dhe kulturë që ka vetëm një qëllim të lartë- interesin e vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Pavarësia dhe krijimi i shtetit të Kosovës është obligim që rrjedh nga vullneti i qytetarëve, është obligim i Grupit të Unitetit ta zyrtarizojë atë. Kosova ka fituar lirinë fizike dhe politike, pra pavarësinë në qershor të vitit 1999, sot ne duhet ta mbrojmë këtë të arritur dhe ta zyrtarizojmë. Partia Demokratike e Kosovës po merr pjesë aktivisht dhe me përkushtuar në këtë proces historik. Objektivi jetësor i secilit nga ne duhet të jetë ndërtimi i shtetit të Kosovës dhe jo ardhja apo ruajtja me çdo kusht e pushtetit.

Me pjesëmarrjen e opozitës në Grupin e Unitetit nuk i krijon imunitet keqeverisjes aktuale. Nuk e justifikon Qeverinë për shkallën e lartë të korrupsionit, për gjendjen alarmante në shëndetësi dhe për degradimet ekstreme në arsimin kosovar, për moszhvillim ekonomik, për mungesë të energjisë elektrike, për papunësinë enorme, për mosangazhimin për kategoritë sociale: pensionistët, invalidët e luftës dhe të punës, të hendikepuarit, që jetojnë në mëshirën e fatit apo të ndihmave sociale. Pasojat e kësaj qeverisje janë evidente edhe në pozicionin aktual politik të negociimit. Deri në një masë është duke u zbehur edhe pozicioni negociator i palës kosovare.

PDK-ja, si opozitë, do të vazhdojë të punojë dhe të kërkojë edhe nga të tjerët të forcohen angazhimi i procesin negociator për arritjen e marrëveshjes për shtetin e Kosovës. PDK-ja si opozitë demokratike do t'i vërë në pah kritikën e bazuar dhe faktet për keqeverisjen. Në të njëjtën kohë, duke punuar që për çështjen e statusit t'i ruajë unitetin kombëtar, qytetar dhe politik.

Kosova e re duhet të jetë shtet i ndërtuar në themele të forta të vlerave demokratike të qytetërimit perëndimor. Pavarësia e Kosovës është zgjidhje reale dhe integruese, që siguron stabilitet dhe perspektivë evropiane për gjithë rajonin. Pavarësia buron nga vullneti dhe nga angazhimi i qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran.

Veton Surroi – anëtar i Grupit Negociator tha se në 10 muajt e fundit kanë punuar në detyrë të veçantë për krijimin e një projekti të ri që ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet popullit shumicë në Kosovë dhe komuniteteve që gjenden me pakicë numerike.

Kemi hartuar një platformë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë. Në metodologji jemi mbështetur në përgjigjet e pyetjeve që na i ka prezentuar z. Ahtisari për atë se si mendojmë se do të dukej Kosova e ardhshme në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve.

Kemi kaluar disa raunde konsultimesh, qoftë në Kosovë, qoftë në Durrës, qoftë në Selanik me ndihmën e madhe të Qendrës Evropiane të Mbrojtjes së të Drejtave të Minoriteteve dhe z. Veler personalisht. Jemi përpjekur të krijojmë konsensus ndërmjet partive politike shqiptare të përfaqësuara në Grupin e Unitetit.

Në këtë dokument baza e mbrojtjes së ardhshme të të drejtave të komuniteteve pakicë është ligji i veçantë kushtetues, të cilin duhet ta miratojë Kuvendi.

Po ashtu, si kategori e re në sistemin tonë kushtetues, do të jetë kategoria e interesit vital - ku definohet se çka është interesi vital i komuniteteve.

Instrumentet e mbrojtjes së komuniteteve do të jenë: në legjislativ nëpërmjet përfaqësimit të garantuar dhe jo të rezervuar.

Kemi futur çelësin e dyfishtë të Badenterit për interesat vitale e kjo do të thotë se asnjë ligj që ka të bëjë me interesat vitale të qytetarëve pakicë, nuk mund të ndryshohet nëse për të nuk voton shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe shumica e anëtarëve të komuniteteve pakicë që gjenden në Kuvend në ditën e votimit.

Kemi integruar në sistemin e ardhshëm kushtetues – juridik Këshillin Konsultativ të Komuniteteve, që do të jetë pranë zyrës së kryetarit të Kosovës dhe kemi futur një qeverisje të re komunale, që është nënkryetari i Kuvendit Komunal nga radhët e komuniteteve pakicë.

Në gjyqësor kemi propozuar forma alternative të mbrojtjes së të drejtave të interesave vitale nëpërmjet formimit të panelit për interesa vitale pranë Gjykatës Kushtetuese, i cili do të merret ekskluzivisht me çështje që kanë të bëjnë me shkeljet eventuale të të drejtave vitale.

Na kanë mbetur edhe tri pika kontestuese pa u zgjidhur. Ne insistojmë që në Kuvend të jenë të drejtat e garantuara e jo të rezervuara, të mos ekzistojë Gjykatë e Apelit të Veçantë për komunitetet dhe pjesëmarrja në Qeveri të mos ketë demonacion etnik.

Këto të drejta nuk mund të kufizohen dhe evaluimi i tyre është pjesë e një procesi evropian.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Grupit Negociator, kryetari e hapi debatin lidhur me ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës.

Gjergj Dedaj (PLK) paraqiti mospajtime me vlerësimet e anëtarëve të Grupit Negociator lidhur me ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës.

Ai propozoi nga Grupi Negociator i Kosovës të shpallet moratorium ose atë ta shkarkojë Kuvendi i Kosovës.

Njëkohësisht propozoi që Kuvendi ta shpallë urgjentisht pavarësinë e Kosovës dhe të fillojë procedurën për hartimin e Kushtetutës së Kosovës, si dhe të kërkojë nga qendrat ndërkombëtare në botë, në SHBA dhe në Evropë, Këshillin e Sigurimit që ta njohin pavarësinë e Kosovës.

Gjylanze Syla – tha se Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet plotësisht punën e Grupit Negociator

Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet t'i gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta, por edhe duhet t'i respektojnë institucionet demokratike të Kosovës dhe ligjet e këtij shtetit.

Grupi Parlamentar i AAK-së inkurajon dhe e përkrah Delegacionin e Kosovës në përpjekjet e tij që propozimet për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës të mundësojnë riintegrimin e qytetit të Mitrovicës.

Duhet filluar me hartimin e Kushtetutës së Kosovës , që është përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës.

Ne e mbështesim edhe më tej punën e Delegacionit të Kosovës, por çdo vendim për të ardhmen e Kosovës duhet të merret në Kuvendin e Kosovës, në përputhje me Rezolutën e Kuvendit për rikonfirmimin e vullnetit të popullit të Kosovës për shtet sovran dhe të pavarur.

Emrush Xhemajli (LPK) paraqiti qëndrimet e Lëvizjes Popullore të Kosovës për vlerësimin e punës së Grupit Negociator lidhur me ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës.

LPK-ja, shtoi deputeti Xhemalji, propozon të pushojë dhe të mos vazhdohet më mandati i personave që janë në Grupin për statusin e vendit. Për t'u realizuar vullneti i qytetarëve të Kosovës pika e parë duhet të pezullohen bisedimet me Beogradin dhe me Serbinë. Të organizohet referendum në Kosovë për statusin e vendit, pas referendumit për Kosovën të vazhdojë dialog me ata që do ta respektonin vullnetin e popullit të Kosovës dhe të vendosen raporte të sinqerta në pajtim me vullnetin e popullit të Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare.

Jakup Krasniqi tha se Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet këtë formë të komunikimit të Grupit Negociator me Kuvendin. Ne edhe pse në fillim i kemi pasur vërejtjet tona serioze, nuk kemi qenë e as nuk jemi opozitë e këtij procesi tepër të rëndësishëm për të sotmen dhe për të ardhmen e Kosovës.

Angazhimi ynë ka qenë dhe vazhdon të jetë vetëm në shërbim të shtetit të pavarur dhe sovran.

Grupi Negociator , përveç ofertës së ofruar duhet t'i ketë edhe këto kërkesa garantuese: Tërësinë territoriale të Kosovës me sovranitet, Kosova me njohje ndërkombëtare dhe ulëse në OKB, Kosova me ushtrinë e saj profesionale, Mitrovica qytet me dy njësi komunale, financimi i komunave për kokë të banorëve të saj, reciprocitetin: për çdo gjë që do ta gëzojnë serbët e Kosovës, ta kenë edhe shqiptarët në Kosovën Lindore në Serbi dhe kudo ku ata jetojnë dhe janë pakicë dhe që Bashkimi Evropian aty ku është edhe vendi ynë të marrë përgjegjësinë për funksionimin e pushtetit në shtetin e ardhshëm të Kosovës.

Sabri Hamiti – anëtar i Kryesisë së Kuvendit – në fillim të diskutimit iu referua Rezolutës së Kuvendit, të miratuar para një viti, për mandatin e Grupit Negociator gjatë bisedimeve për statusin e Kosovës.

Grupi i Unitetit deri më tash ka zhvilluar bisedime për pozitën e minoriteteve në Kosovë, duke e pasur parasysh në radhë të parë minoritetin serb, por nuk kanë biseduar kurrë për shumicën, për asgjë. Grupi i Unitetit kurrë nuk ka biseduar për statusin final të Kosovës.

Decentralizimi një herë ka dalë si emër i dytë për transformimin e pushtetit lokal, por tash po ndahet bashkësia, sepse pushtet qendror pos improvizimeve ne nuk kemi pasur në Kosovë, nën UNMIK-un. Puna ka qenë ndërtimi i komunave me shumicë serbe - interpretimi im është që është bërë një kirurgji tokësore e Kosovës me premisa të banimit me shumësi etnie, që nuk është punë e mirë as për shqiptarët e as për serbët. Kjo është provë që të enklavizohen minoritetet, konkretisht serbët që të krijojnë një jetë paralele politike, të financohen në mënyra të ndryshme dhe më në fund që të dirigjohen dhe të bëhen instrument i Beogradit.

Çështja tjetër është një pako e madhe e të drejtave të minoriteteve që pretendon njëfarë parakushtetute të minoriteteve . Kjo s'ka të bëjë me liritë, këtu ka të bëjë me krijimin e pabarazive në të gjitha nivelet. Me këtë ligësohen pabarazia dhe përfaqësimi

joproporcional edhe vota e deputetëve në këtë Parlament s' do ta ketë të njëjtën vlerë, sepse do të ketë votim të dyfishtë edhe në komuna.

Ka edhe propozime të organeve inekzistente deri më sot në legjislacion dhe në Qeverinë e Kosovës do të ketë këshillin konsultativ që bëhet organ qeveritar, a i bashkëngjitet kryetarit apo kryeministrit nuk ka rëndësi fare dhe në anën tjetër propozohet ligjit kushtetues. Me këto krijojmë, në mënyrë institucionale, pa barazi ndërmjet qytetarëve.

Dhe në fund, unë e çmoj dëshirën e Ekipit të flasë lirisht për punën e vet, por kërkoj prej tyre të bëhen konstitucionalë, sistematikë dhe t'i raportojnë Kuvendit në përputhje me mandatin që e kanë sipas Rezolutës së Kuvendit lidhur me bisedimet për statusin e vendit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportimin e anëtarëve të Grupit Negociator dhanë edhe këta deputetë : **Nait Hasani, Xhevat Bislimi, Melihate Tërmerkollli, Nazim Jashari, Hydajet Hyseni, Nekibe Kelmendi dhe Xhezair Murati**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetarët e grupeve parlamentare kërkuan që seanca e sotme t'i ndërpresë punimet në mënyrë që deputetët të kenë kohë të mjaftueshme për t'i analizuar dokumentet e Grupit Negociator, që u ishin shpërndarë sot.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për 56,
Kundër 8.

Kryetari konstatoi: seanca e sotme i mbyll punimet për t'i vazhduar të martën, në orën 10.

6 shtator 2006

Vazhdim i seancës.

Kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha, në cilësinë e anëtarit të Grupit Negociator tha se puna e deritanishme e Grupit të Unitetit, në kuadër të cilit janë angazhuar një numër i madh njerëzish, si në Grupin Politik-Strategjik, për Pushtetin Lokal, në Këshillin Konsultativ Komunitete, si dhe ekspertë të tjerë të fushave të caktuara kanë dhënë kontributin e tyre në këto bisedime. Por, e gjithë puna – të gjitha dokumentet që janë hartuar duhet të miratohen në Kuvendin e Kosovës.

Në dokumentit e parë që i është dhënë z. Ahtisari thuhet se “Delegacioni i Kosovës u qaset bisedimeve për reformën e pushtetit lokal duke u mbështetur në qëndrimin se nuk mund të ketë marrëveshje për asnjë element të pakos për zgjidhjen e statusit përfundimtar, përderisa të mos arrihet marrëveshja për pakon në tërësi”.

Këtij parimi i jemi përmbajtur dhe do të vazhdojmë t'i përmbahemi deri në fund.

Bisedimet nuk u zhvilluan me palën serbe, por kryesisht me atë ndërkombëtare, ose në prani të saj dhe vetëm për çështje teknike që natyrshëm lindin si pasojë juridike e statusit.

Në ato bisedime asnjëherë deri më tani, para nesh, nuk është shtruar çështja e statusit, nuk është shtruar ajo se, a do të jetë apo jo Kosova e pavarur, ngase me këtë çështje është marrë Grupi i Kontaktit, i cili, herët e bëri të ditur cili do të jetë statusi i Kosovës. Të gjitha bisedat janë zhvilluar për modalitetet passtatusore. Prandaj, është i pabazë mendimi se kemi qenë shumë dorëlibër, se kemi dhënë çdo gjë që është kërkuar nga ne etj.

Kemi refuzuar dhe do të vazhdojmë të refuzojmë çdo kërkesë që do ta cenonte integritetin territorial dhe politik të Kosovës dhe përcaktimin tonë për pavarësinë e Kosovës, pavarësisht se nga kush vjen.

Kemi ofruar zgjidhje për të cilat jemi përcaktuar vetë, për të mos lejuar arbitrimin që do të ishte formë shumë më e dhimbshme.

Pala kosovare ka kundërshtuar kërkesën e Beogradit që të mund të ndihmojë drejtpërdrejtë zhvillimin e komunave serbe në Kosovë në fushën ekonomike, shëndetësore, të arsimit etj, por ka mundësuar që këto lloj ndihmash mund të realizohen vetëm nëpërmjet marrëveshjeve ndërqeveritare, përkatësisht, me anë të kontrollit rreptë nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Grupi i Unitetit gjatë gjithë punës ka qenë unik – çdo vendim është marrë me konsensus.

Kryetari e hapi debatin.

Ferid Agani – Grupi Parlamentar për Integrim - tha se mungesa e transparencës në punën e Grupit të Unitetit ka qenë e palejueshme. Së dyti, është e papranueshme mungesa e iniciativës politike në procesin e deritashëm të bisedimeve. Përkundër synimeve dhe punës që keni bërë në vitin e kaluar janë duke u rishikuar hartat administrative e Kosovës përgjatë vijave etnike.

Pa sigurimin e shkallës së plotë të sovranitetit të vendit zgjidhjet politike dhe administrative, të dërguara nga ju - UNOSEK-u do të paraqesin derë të hapur për përkeqësimin e situatës së sigurisë në Kosovë edhe të stabilitetit në rajon.

Si çështje urgjente e parashtrori propozimin e Partisë së Drejtësisë, të mbështetur nga Grupi Parlamentar për Integrim, që Kuvendi i Kosovës në këtë seancë të nxjerrë Deklaratë me të cilin i informon shtetet, Grupin e Kontaktit dhe anëtarë të tjerë të Këshillit të Sigurimit, se propozimet e ofruara nga Grupi i Unitetit gjatë bisedimeve teknike në Vjenë do të mbështeten nga Kuvendi i Kosovës vetëm në rastin kur Kosovës do t'i garantohet sovraniteti i plotë me sigurimin e përfaqësimit të saj si shtet i pavarur në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me të drejta të barabarta si të gjitha shtetet e tjera anëtare të OKB-së.

Kërkoj që ta hidhni në votim këtë propozimin.

Ramë Buja – anëtar i Kryesisë së Kuvendit – kërkoi nga Grupi Negociator që para çdo takimi për çështjet që diskutohen në Vjenë paraprakisht të shqyrtohen në Kuvend.

Dokumenti i hartuar për çështjen e decentralizimit në Grupin Politik ka pësuar ndryshime në fazën kur ka kaluar në Grupin e Unitetit dhe ka pësuar ndryshime përsëri kur ka kaluar nga Grupi i Unitetit për t'iu dorëzuar Ahtisarit. Për këto ndryshime, ne si grup parlamentar kemi shfaqur shqetësimin tonë.

Pavarësisht kush e ka iniciuar, kush e ka vazhduar dhe kush po përpiqet ta përmbyllë këtë çështje- është mbrapshtë dhe e bërëkeq për ata që duan të getoizohen dhe të

enklavizohen, në rend të parë për rininë serbe, pastaj për ne si parlamentarë dhe për gjithë Kosovën.

Serbia asnjëherë nuk ka bërë luftë për ide, për ideologji, por ka bërë luftë për territore. Tendenca e krijimit të komunave të reja është që nesër ajo të ketë legjitimitet mbi territoret e caktuara që do të thotë ta bosnizojë Kosovën.

Ne të Grupit Parlamentar të PDK-së propozojmë që Kosovës të mos i cenohen në asnjë mënyrë pavarësia dhe sovraniteti. Kosova të ketë ulëse në Kombet e Bashkuara, të ketë ushtrinë e saj profesionale, finacimi i komunave të jetë në bazë të numrit të banorëve dhe gjithsesi të përmendet edhe çështja e reciprocitetit për të drejtat e pakicave në këto bisedime.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportimin e anëtarëve të Grupit Negociator dhanë edhe këta deputetë: **Zylfije Hundozi, Remzije Nimani, Ramadan Kelmendi, Bajram Kosumi, Mark Krasniqi, Mahir Yagcilar, Ylber Hysa, Numan Baliq, Bajram Rexhepi, Naim Maloku, Behxhet Brajshori, Ragip Zekolli, Xhezair Murati, Berat Luzha, Bislim Hoti, Xhevdet Neziraj, Sevdije Halimi, Nazim Jashari, Fetah Berisha, Jakup Krasniqi, Alush Gashi, Gjylnaze Sylja, Teutë Sahatqija, Xhezair Murati, Nexhat Rexha, Safete Hadërgjonaj, Hydajet Hyseni, Ymer Halimi, Hajredin Hyseni, Ramadan Musliu, Bajrush Xhemajli, Ilmi Ahmeti, Jusuf Sutaj, Xhevat Bislimi, Flora Brovina, Nait Hasani, Myrvete Dreshaj, Ymer Muhaxheri, Zef Morina, Emrush Xhemajli dhe Gjegj Dedaj**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit **anëtarët e Grupit Negociator** veç e veç, i falënderuan deputetët e Kuvendit për vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, të cilat, shtuan ata, se do t’iu shërbejnë si bazë e mirë për bisedimet e ardhshme për statusin e Kosovës.

Kryetari i Kuvendi, **Kolë Berisha**, në përmbyllje të punimeve të seancës dyditore, tha se pjesëmarrja e deputetëve në debat e arsyeton mbajtjen e kësaj seance. Grupi Negociator edhe në të ardhmen do të jetë i gatshëm që t’i raportojë Kuvendit për rrjedhën e bisedimeve për statusin e Kosovës.

Shënim: Pjesë përbërëse e këtij procesverballi është transkripti i kësaj seance.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 18:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale